



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 38/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit “Riinvest”, Nr. 3480/21H datë 29.10.2021 për akreditim të programeve të studimit:
 - Menaxhim Biznesi, BA, 180 ECTS (ri akreditim)
 - Marketing Dixhital, Baçelor Profesional, 180 ECTS (akreditim)
 - Menaxhimi i Hotelërisë, Baçelor Profesional, 120 ECTS (akreditim)
 - Dizajn, Baçelor Profesional, 180 ECTS (akreditim)
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji “Riinvest” ka parashtruar kërkesë (Nr. 3480/21H datë 29.10.2021) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit: Menaxhim Biznesi, BA, 180 ECTS (ri akreditim), Marketing Dixhital, Baçelor Profesional, 180 ECTS (akreditim), Menaxhimi i Hotelërisë, Baçelor Profesional, 120 ECTS (akreditim), Dizajn, Baçelor Profesional, 180 ECTS (akreditim).

1/2

Bazuar në pikën 1.2 të Nenit 10 të UA për Akreditim ku thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuar në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së", KShC në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Kolegj.

- **Për programin Menaxhim Biznesi, BA, 180 ECTS**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Visar Vokri (PhD në Shkenca Ekonomike-Ekonomi Politike), Lumir Abdixhiku (PhD në Ekonomi) dhe Durim Hoxha (PhD në Ekonomi të Bizneseve).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve".

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se bartësi Lumir Abdixhiku, ka marrëdhënie pune me orar të plotë të punës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

- **Për programin Marketing Dixhital, Baçelor Profesional, 180 ECTS**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Bujan Stavileci (MA në Menaxhment-Marketing), Malësore Gashi (MA në Sistemin e Informacionit për Menaxhment), Albnora Hoti (MSc në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri), Blerim Jahiu (MSc në Informatikë), Astrit Desku (MSc në Shkenca Kompjuterike) dhe Urgan Alija (MSc në Administrim Biznesi).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve".

Sipas Nenit 27, pika 5.1. të UA për Akreditim 15/2018, kërkohet që: "Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i përzgjedhur në procedurë transparente".

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për Akreditim 15/2018, KShC ka konstatuar se asnjëri nga bartësit nuk ka paraqitur dokument i cili dëshmon përvojën relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse. Po ashtu, bartësi Urgan Alija figuron si i punësuar me orar të plotë nga një punëdhënës tjetër.

Bazuar në faktet e prezantuar me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Marketing Dixhital, Baçelor Profesional, 180 ECTS.

- **Për programin Menaxhimi i Hotelerisë, Baçelor Profesional, 120 ECTS**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Gent Beqiri (MA në Shkenca ekonomike, Menaxhment dhe Informatikë), Dorina Kralani (MSc në Biznes Ndërkombëtar), Etnike Dibrani (MSc në Gjeografi) dhe Diandra Nela (MSc në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve”.*

Sipas Nenit 27, pika 5.1. të UA për Akreditim 15/2018, kërkohet që: *“Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i përzgjedhur në procedurë transparente”.*

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për Akreditim 15/2018, KShC ka konstatuar se asnjëri nga bartësit nuk ka paraqitur dokument i cili dëshmon përvojën relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse. Po ashtu, bartësja Etnike Dibrani figuron si e punësuar me orar të plotë në dy vende të punës.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Menaxhimi i Hotelerisë, Baçelor Profesional, 120 ECTS.

- **Për programin: Dizajn, Baçelor Profesional, 180 ECTS**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Yll Rugova (MA në Dizajn Grafik), Zana Nixha (MA në Arkitekturë), Majlinda Bilalli (MA në Arkitekturë), Neshat Shala (MA në Arkitekturë), Freskim Sylejmani (MA në Arkitekturë) dhe Flamur Grajçevci (MA në Arkitekturë dhe Dizajn Urban).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve”.*

Sipas Nenit 27, pika 5.1. të UA për Akreditim 15/2018, kërkohet që: *“Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i përzgjedhur në procedurë transparente”.*


Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për Akreditim 15/2018, KShC ka konstatuar se bartësit Yll Rugova, Zana Nixha, Majlinda Bilalli, Neshat Shala dhe Flamur Grajçevci nuk kanë paraqitur dokument i cili dëshmon përvojën relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse. Po ashtu, bartësit Yll Rugova, Majlinda Bilalli, Neshat Shala dhe Flamur Grajçevci figurojnë si të punësuar me orar të plotë në dy vende të punës.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Dizajn, Baçelor Profesional, 180 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Pastaj, ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Riinvest”
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

